



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Paneli i përbërë prej Gjykatësit të Vetëm
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 nëntor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara
F00261 dhe F00265**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Specializuar
Tobi Kadman

GJYKATËSI I VETËM,¹ në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 82(5) dhe 84 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 korrik 2022, mbrojtësi i Driton Lajçit (“Mbrojtja”) i dorëzoi Gjykatësit të Vetëm një kërkesë të dytë për urdhërimin e pushimit të hetimit kundër Driton Lajçit (“z. Lajçi”).²
2. Më 3 tetor 2022, Gjykatësi i Vetëm nxori një vendim me anë të të cilit hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për urdhërimin e pushimit të hetimit kundër z. Lajçi (“Vendimi i Kundërshtuar”).³
3. Më 10 tetor 2022, Mbrojtja kërkoi leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar (“Kërkesa për Leje për Apel”).⁴
4. Më 21 tetor 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi përgjigjen e saj (“Përgjigja”).⁵

¹ KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit, 29 maj 2018, publik.*

² KSC-BC-2018-01, F00238, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesa e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 4 korrik 2022, publike.* Një version i korrigjuar me Shtojcat konfidenciale A dhe B është dorëzuar më 25 korrik 2022, F00238/COR.

³ KSC-BC-2018-01, F00258, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 3 tetor 2022, konfidencial.* Versioni i redaktuar publik është dorëzuar më 27 tetor 2022.

⁴ KSC-BC-2018-01, F00261, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë për Miratimin e Lejes për Apel kundër Vendimit mbi Kërkesën e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 10 tetor 2022, konfidenciale.*

⁵ KSC-BC-2018-01, F00264, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Driton Lajçit për Miratimin e Lejes për Apel kundër Vendimit mbi Kërkesën e Dytë për Pushimin e Hetimit (KSC-BC-2018-01/F00258), 21 tetor 2022, konfidenciale.* Varianti i redaktuar publik është dorëzuar më 1 nëntor 2022, F00264/RED.

5. Më 24 tetor 2022, Mbrojtja u kundërpërgjigj ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigja”).⁶
6. Më 31 tetor 2022, Gjykatësi i Vetëm miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes për leje për apel (“Vendimi për Miratimin e Lejes për Apel”).⁷
7. Më 4 nëntor 2022, Mbrojtja dorëzoi një kërkesë për riklasifikimin e Kërkesës për Leje për Apel dhe të Kundërpërgjigjes së saj si “publike” (“Kërkesa”).⁸

II. PARASHTRIME

8. Mbrojtja i referohet Vendimit për Miratimin e Lejes për Apel, me anë të të cilit Gjykatësi i Vetëm e urdhëroi Mbrojtjen të dorëzonte një version të redaktuar publik të Kërkesës për Leje për Apel (F00261) dhe të Kundërpërgjigjes (F00265) (bashkërisht, “Parashtrimet e Protokolluara”).⁹ Ajo argumenton se i ka dorëzuar këto dokumente si “konfidenciale” si shenjë përkujdesjeje në pritje, mes të tjerave, të rishikimit të pikave të kundërshtuara, argumenteve të Vendimit të Kundërshtuar dhe klasifikimit të tij.¹⁰ Ajo citon nevojën që procedurat të jenë publike, dhe pohon se Parashtrimet e Protokolluara nuk përmbajnë materiale konfidenciale.¹¹
9. Rrjedhimisht, Mbrojtja kërkon që Parashtrimet e Protokolluara të riklasifikohen si “publike”.¹²

⁶ KSC-BC-2018-01, F00265, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Miratimin e Lejes për Apel kundër Vendimit mbi Kërkesën e Dytë për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Laçit* (KSC-BC-2018-01/F00258), 24 tetor 2022, konfidenciale.

⁷ KSC-BC-2018-01, F00267, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apel kundër Vendimit F00258*, 31 tetor 2022, konfidencial.

⁸ KSC-BC-2018-01, F00268, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara KSC-BC-2018-01/F00261 dhe KSC-BC-2018-01/F00265*, 4 nëntor 2022, publike.

⁹ Kërkesa, para. 17, që i referohet Vendimit për Miratimin e Lejes për Apel, para. 32 dhe 33(c).

¹⁰ Kërkesa, para. 17.

¹¹ Kërkesa, para. 18.

¹² Kërkesa, para. 18.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet panelit kërkesë për riklasifikim.

11. Sipas rregullës 84(1) të Rregullores, paneli rregullisht rishikon klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave, dhe, kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e statusit të dokumentacionit përkatës.

IV. DISKUTIM

12. Gjykatësi i Vetëm rikujton se me Vendimin për Miratimin e Lejes për Apel, ai urdhëroi edhe Mbrojtjen edhe ZPS-në të dorëzonin versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre me informacionet e redaktuara në përputhje me ato të versionit publik të Vendimit të Kundërshtuar (F00258/RED) dhe me parashtrimet e ZPS-së që i paraprinë atij (F00240/RED).¹³ Që nga ajo kohë, ZPS-ja ka dorëzuar variantin publik të Përgjigjes së saj sipas urdhrit të Gjykatësit të Vetëm.

13. Gjykatësi i Vetëm vëren se parimisht duhet të vihen në dispozicion të publikut parashtrimet me shkrim të këtij procesi gjyqësor, kur është e mundur. Megjithatë, Parashtrimet e Protokolluara në fjalë përmbajnë informata të ndjeshme të cilat mund të minojnë hetimet në rast se bëhen publike. Bazuar mbi këtë, Gjykatësi i Vetëm hedh poshtë Kërkesën dhe urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë një version publik të Parashtrimeve të Protokolluara me redaktime të cilat të

¹³ Vendimi për Miratimin e Lejes për Apel, para. 32 dhe 33(c).

bazohen mbi redaktimet e bëra në versionet publike të Vendimit të Kundërshtuar dhe të Përgjigjes.¹⁴

14. Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të Kërkesës dhe faktin që ajo hidhet poshtë nga vendimi aktual, Gjykatësi i Vetëm është i mendimit se ZPS-ja nuk dëmtohet nga lëshimi i këtij vendimi para marrjes së përgjigjes së saj ndaj Kërkesës.

V. VENDIM

15. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- a) **HEDH POSHTË** Kërkesën; dhe
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë versione të redaktuara publike të Kërkesës për Leje për Apel (F00261) dhe të Kundërpërgjigjes (F00265) deri të **premtën, 18 nëntor 2022**, në përputhje me paragrafin 13 më lart.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Vetëm

E premte, 11 nëntor 2022
Hagë, Holandë.

¹⁴ Për shembull, Gjykatësi i Vetëm vëren, sa për ilustrim, se në versionin e redaktuar publik të Përgjigjes, paragrafi 12, ZPS-ja ka zbatuar redaktimet që përkojnë me informacionin e paragrafëve 21-23 dhe 25-26 të versionit të redaktuar publik të Vendimit të Kundërshtuar.